



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA “ALBPETROL” SHA
DREJTORIA E PROKURIMEVE

Nr. _____ Prot.

Patos më, ____ .05.2025

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Mirëmbajtje e infrastrukturës së rrjetit , sigurisë, server dhe storage për shoqërinë Albpetrol.sh.a për periudhë 2 vjetare”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 50312310-1 - Mirëmbajtje e pajisjeve të rrjetit të të dhënave

VLERA E FONDIT LIMIT: 43,548,200 (dyzet e tre milion e pesëqind e dyzet e tetë mijë e dyqind) Lekë pa TVSH ose 445,597 (katërqind e dyzet e pesë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e shtatë) Euro pa TVSH me kursin e kembimit të datës 19.05.2025

Bazuar në nenin 39 të ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” parashtrojmë arsyet kryesore për vendimin e mosndarjen në lote për këtë procedurë.

Objekti i prokurimit është konceptuar si një i tërë dhe për këtë arsye është e pamundur të ndahet në lote.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Albpetrol sha ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, **sipas Shtojcës 10.**

b. Sigurimin e Ofertës, **sipas Shtojcës 3;**

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.1.1. Kapaciteti ligjor plotësohet duke dorëzuar dokumentat sipas Kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- 2.2.1. Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023, 2024 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vendosija e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP dhe ligjin nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

- 2.3.1. Shërbime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se: 40 % e fondit limit objekt prokurimi, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen të paraqiten:

Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e shërbimeve të realizuara.

OSE

Në rastin e përvojes së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e shërbimeve të realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

- 2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar për mirëmbajtjen e pajisjeve Hardëare të prodhuesve të paraqitura në specifikime. Ky autorizim duhet të përfshijë kontaktet e plota të prodhuesit ose distributorit të autorizuar, si: numrin e telefonit, adresën e e-mailit dhe faqen e internetit. Në rast se autorizimi është lëshuar nga distributori i autorizuar, duhet të sigurohet vërtetimi i marrëdhënies midis tij dhe prodhuesit. Po ashtu, në deklaratën e lëshuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar, duhet të konfirmohet se pajisjet e ofruara, do të jenë të pajisura me sistemin origjinal të prodhuesit (OEM).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Kërkesa për paraqitjen e autorizimeve të prodhuesve ose distributorëve për suportin e pajisjeve që do të mirëmbahen garanton se operatorët ekonomikë janë të autorizuar nga prodhuesi apo distributori i autorizuar, dhe bën të mundur sigurimin e suportit dhe shërbimeve të garantuara për produktet dhe shërbimet sipas TOR.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat ISO ose të përditësuara, ose ekuivalente (të vlefshme dhe të akredituara nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).

- Certifikate për menaxhimin e cilësisë ISO 9001:2015;
- Certifikate për menaxhimin e sigurisë së informacionit ISO 27001:2023;
- Certifikate për menaxhimin e shërbimeve ISO/IEC 20000-1:2018;

Argumentimi: Kërkesa për këto certifikata është në përputhje me nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar dhe nenit 79, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimit publik”.

ISO 9001-2015 - Ky standard është i nevojshëm për certifikimin në realizimin e cilësisë, identifikimin e rreziqeve, caktimin e burimeve të nevojshme për të kontrolluar nëse shërbimet e ofruara janë të cilësisë së duhur si dhe kontrollin e proceseve.

ISO 27001:2023 - Ky standard është i nevojshëm për krijimin, zbatimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të një sistemi të menaxhimit të sigurisë së informacionit. Ky standard përfshin kërkesat për vlerësimin dhe trajtimin e rreziqeve të sigurisë së informacionit të përshtatura me nevojat e organizatës, në mënyrë që informacioni të mbetet i sigurt dhe siguria e sistemeve të saj të mos rrezikohet nga sulmet kibernetike.

ISO 20000-1:2018 - Ky standard është i nevojshëm për të specifikuar kërkesat për krijimin, zbatimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të një sistemi të menaxhimit të shërbimit. Ky sistem mbështet menaxhimin e ciklit jetësor të shërbimit, duke përfshirë planifikimin, projektimin, tranzicionin, ofrimin dhe përmirësimin e shërbimeve që plotësojnë kërkesat e dakorduara dhe u japin vlerë konsumatorëve, përdoruesve dhe organizatës së ofruesit të shërbimit. Ky standard u jep mundësi kompanive të demonstrojnë aftësitë e tyre profesionale në zbatimin e projekteve të teknologjisë së informacionit.

Sa më sipër janë kërkuar certifikata që vërtetojnë se ofertuesit kanë sisteme menaxhimi sipas standardeve ndërkombëtare, të cilat reflektojnë qartë në cilësinë e shërbimit. Kërkesat janë të mjaftueshme për t'u pajisur ofertuesit me kapacitete teknike cilësore të certifikuara me certifikata të njohura ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë. Certifikatat e kërkuara për OE janë proporcionale dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore. Certifikatat e kërkuara janë vendosur në përputhje me specifikimet teknike dhe janë vlerësuar të nevojshme.

2.3.4 Për të vërtetuar që operatori ekonomik ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë e cilësi të kontratës, duhet të ketë staf teknik minimalisht 6 (gjashtë) punonjës të diplomuar me arsim të lartë.

Për këtë të paraqiten:

Diploma e arsimit të lartë përkatëse.

Listëpagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit, në të cilat specialistët e mësipërm duhet të figurojnë.

Shenim: Për përmbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.10. Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër

Argumentimi: Kërkesat për punonjës janë kërkuar në bazë të pikës 4 të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, ku nëpërmjet këtij kriteri provohet se operatorët ekonomikë provojnë se kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit. Albpetrol sh.a duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për zbatimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë staf teknik të kualifikuar për implementimin e projektit, sipas certifikatave të mëposhtme:

- Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në ITIL për menaxhimin e shërbimeve TI.
- Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në nivel profesional nga prodhuesi për pajisjet e rrjetit switch.
- Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në nivel profesional nga prodhuesi për pajisjet e sigurisë (firewall).
- Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në nivel profesional nga prodhuesi për pajisjet server.
- Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në nivel profesional nga prodhuesi për pajisjen storage.
- Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar nga prodhuesi për virtualizim.

Shënim: Pranohen rastet kur një punonjës disponon më shumë se një certifikatë, por që në mënyrë të kombinuar stafi të plotësojë minimumin e certifikatave/dëshmime të kërkuara.

Për secin punonjës të paraqiten:

- Certifikata përkatëse.
- Listëpagesat e shoqërisë për të paktën tre muajt e fundit në të cilat punonjësit me certifikatat e sipërpërmendura duhet të figurojnë

Shënim: Për përmbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojces nr. 10. Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Kërkesat për punonjës të certifikuar janë kërkuar në bazë të pikës 4 të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, ku nëpërmjet këtij kriteri provohet se operatorët ekonomikë provojnë se kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit. Albpetrol sh.a duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për zbatimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar. Kërkesat për punonjësit e mësipërm janë hartuar duke iu referuar termave të referencës.

- Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në ITIL për menaxhimin e shërbimeve TI. Operatori ekonomik duhet të ketë patjetër një punonjës të certifikuar si për menaxhimin e shërbimeve TI. Ky kriter demonstroi aftësinë e ofruesit të shërbimit për të planifikuar, zbatuar, operuar, monitoruar, shqyrtuar, zgjidhur problematika që do të raportohen gjatë mirëmbajtjes dhe suportit të pajisjeve të prokuruar.
- Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në nivel profesional nga prodhuesi për pajisjet e rrjetit switch. Ky certifikim është një kriter i rëndësishëm për operatorin ekonomik që do të kryejë shërbimin për shkak të ngarkesës dhe numrit të konsiderueshëm të pajisjeve “switch” që përfshin infrastruktura.

- Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në nivel profesional nga prodhuesi për pajisjet e sigurisë (firewall). Ky certifikim është kriter i rëndësishëm sepse projekti përfshin dhe mirembajtjen e pajisjeve të sigurisë. OE duhet të dëshmojë që ka kompetencat e nevojshme për të operuar dhe suportuar plotësisht pajisjet në fjalë, vërtetuar kjo me anë të certifikatave të lëshuara nga prodhuesi i pajisjeve përkatëse.
- Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në nivel profesional nga prodhuesi për pajisjet server. Ky certifikim është kriter i rëndësishëm sepse projekti përfshin dhe mirembajtjen e pajisjeve server. OE duhet të dëshmojë që ka kompetencat e nevojshme për të operuar dhe suportuar plotësisht pajisjet në fjalë, vërtetuar kjo me anë të certifikatave të lëshuara nga prodhuesi i pajisjeve përkatëse.
- Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në nivel profesional nga prodhuesi për pajisjen storage. Ky certifikim është kriter i rëndësishëm sepse projekti përfshin dhe mirembajtjen e pajisjeve storage. OE duhet të dëshmojë që ka kompetencat e nevojshme për të operuar dhe suportuar plotësisht pajisjet në fjalë, vërtetuar kjo me anë të certifikatave të lëshuara nga prodhuesi i pajisjeve përkatëse.
- Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar nga prodhuesi për virtualizim. Ky certifikim është një kriter i rëndësishëm për përzgjedhjen e operatorit ekonomik sepse makinat janë të instaluar në platformat e virtualizimit dhe OE duhet të demonstrojë aftësinë për të përdorur këtë platformë virtualizimi.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga specialistet e fushës të cilët kanë njohuri të posacme për objektin e prokurimit.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Njesia e prokurimit: